

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	14/09 2024		
Nr. Org.	Numër	Shtigëza	Vlera
01-	052/m	47958	


Raport i Dëgjimit Publik

Shpronësimi i Pronës së
Paluajtshme të vendimit nr.01-
464/01-40545



Gusht
2022

HYRJE



- Dëgjimin Publik për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme u mbajt më 16.08.2022, në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.
- Të pranishëm ishin : Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkyryetari Arben Shala si dhe drejtori i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi në Komunën e Drenasit, Ruzhdi Lestrani.
- Duke i falenderuar për pjesëmarje dhe duke ju uruar mirësearchje në dëgjimin publik, drejtori Lestrani dha sqarimet e nevojshme për pjesëmarrësit.
- Pas kësaj fjalës dha kryetarit të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.



- Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.01-464/01-40545, dt. 0508.2022, janë njoftuar të gjitha subjektet e interesit se do mbahet dëgjim publik lidhur me shpronësimin e pronave në fjalë.

- Ky njoftim ishte publikuar në webfaqen e Komunës së Drenasit, tek "Vendimet e Kryetarit".

<https://kk.rks-gov.net/gillogoc/wp-content/uploads/sites/10/2022/08/njoftimi.pdf>



Njoftimi për Dëgjimin Publik për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme

Republika Karovi
Kembla Drivess Kırklığı
Kryeleri İ Komueño

Nr. 01-02903 406,90 d1.05.02.2021

MINTON

Nie soebelstece te photogrammet & 3D memt 8 te L-147 te 2015 te Drosdumonk & Prinses te Palaujungte, me
niederschlingte die photogrammet & bera me L-147-NL-1-L-2015 te Drosdumonk & Prinses te Palaujungte te Konservas
ne (11-060101-104545, ch 03 08.2022 opnthonen te dijke subjeket te mikroscopie.

2. Kreyolan | Kauwes do ia mané, aje Vendola Preliminary brende penanté, jey 10 dekádi laténté par penanté, se kulevve le pénanté na norme Le Ligin N°117-19 per Seporantéan Prokés, se Palunggutan lha, piyaluané e bera nme Ligin N°01-12-2015, ikuhan mo angkatané e duguine publik.

3. Qdo person i mrengue la te dirige té pengue konrecte e tju me shikero ikuhan me alprenanum e propulsor na Optimo Stargear, benua 10 dálke laténté, mbaas alprenanum e Vendiman e Kreyolan. 01-01-2015-01-05 08:20:00

4. Kryolan | Konuswets do 12 mbaie que deigien publik liefers nie dieperseksualiteit = berlaar piek naliemers en Plein! Zhuolinmer Konuswet 2010, 2010, die Marlo, 2012-2010, neer

• A Pekanom e Kunumaa ou é no suporte da sua cultura para o desenvolvimento sustentável da sua comunidade. A Pekanom e Kunumaa é uma organização comunitária que promove a preservação e a valorização da cultura e da natureza da comunidade de Pekanom e Kunumaa.

prorok ose roduvane vó uherestie ne pronom = sile. Bludnici ně bězí pýše oce zvouci opes
před sejma i lugtem vó kdyži pýšovat. kouzle tě dívajte k marni pýše ne dělují
publik.

6. Cântă petrecă sărbătorile de Crăciun și Sf. Nicolae și să sărbătorească pe calea Inspectoratului de Poliție Judecătorească din județul Iași în perioada 2-3 decembrie 2012.

NYETARI I KOMUNÉ

Lugli. Nr. 03 L-139 per Suprematum e Protes. se Phasianum, inc. neophytum abe-
plantes et bona mea Lugli. Nr. 03 L-205.

9. Ně rádi se provádějí objekty i když jsou slavnostně představeny nebo přemýšljeny s procedurami až do konání.



per l'imprescindibilità di una certa permanenza se bene non prese, obiettivo e pernientemente ad appurare se prima, o comunque in qualche momento, si sia dimostrata la presenza di un soggetto che ha compiuto il delitto. La prova fotografica è così venuta da Cagliari nel 1961, 1962 e 1963, mentre si è cercato di stabilire se il soggetto fosse lui o no.

10. **Dile** (**deconstrucción**) cito: nuk. Edad en la que se critica todo lo establecido y se abren las posibilidades de lo que viene. Se aplica tanto a la cultura como a la ciencia y a la filosofía.

Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme

Takimin e hapi Ruzhdri Lestrani-drejtor i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi në Komunën e Drenasit. Pasi i përhëndeti të pranishmit i njoftoi ata për rregullat qe arsyjen e takimit.


- Pas kësaj fjalë ju dha kryetarit të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

Kryetari Lladrovci – Përsyhendje për të gjithë, iu falenderojë për kohën që keni gjitet për të ardhur sot në këtë takim.

Ju e dini që e kemi shpallur zonën me interes për Komunën, zonën që e keni në shfrytëzim ju dhe e kemi dëgju shpronësimin në Zyrën për Shpronësim në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për mua vlera të ulëta apo të larta për shpronësimin e banesave apo objekteve që i shfrytëzoni ju nuk është me rendësi sepse është punë e dikujt tjetër. Unë nuk kam drejtë as ligjërisht me interreferu në ato vlera që i caktos institucioni përgjegjës shtetëror. Uhë kam dashtë me ju ndarë banesa në vlerë proporcionale me ato banesa që ju i shfrytëzoni por nuk është në dorën time të bëjë vlerësimë tjera nga ato që i bënë zyra shtetërore përvlerësim.

Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme




Kryetari Lladrovci – Ne jemi këtu me i zgjidhë çështjet që na takojnë neve, nuk jemi këtu për me ndërhy në ato çështje që nuk janë nën juridikcionin tonë.

Çdo kush që nuk pajtohet me vlerësimin që kanë bërë zyra shtetërore për vlerësim e ka të drejtën për ankesë në gjykatë.

Dërgoni në Gjykatë çdo gjë që nuk pajtoheni sepse nëpërmjet mjeteve ligjore mund të arrini objektivat tuaja dhe vlerësimet që ju pretendoni që duhet të jenë për shpronësimin e objekteve që ju i shfrytëzoni.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Murtez Zogu (Shfrytëzues i banesës që ju bëhet shpronësimi) – Meqenëse jam një ndër më të vjetrit këtu ju përshëndes dhe e mirëpres këtë takim me i dëgju hallet tona si banues të asaj lagje.

Kryetar që në fillim po të them dëshira e imja dhe e gjithëve që jemi këtu nuk është me vrapi nëpër Gjykata e me u zgjatë e stërgjatë nëpër procese gjyqësore sepse edhe nëse Gjykata na dhjetfishon vlerën e atyre banesave që janë në shfrytëzim tonin sepse nuk dëshirojmë që pas disa viteve me u gjobitë Komuna jonë për mosvlerësim real të atyre pronave.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme

Murtez Zogu (Shfrytëzues i banesës që ju bëhet shpronësimi) – Ju kryetar po jau kutojë se jeni ardhë me votën tonë, ngase jeni ardhur me votën tonë duhet me na përfaqësu denjësish interesi tona. Lagja ku jetojmë ne ka qenë lagja e pare e ubranizume në Komunën e Drenasit.

Lagja që e ka themelu këtë komunë. Kuadrot që kemi banuar në atë lagje jemi kanë kuadro që ka pas nevojë Komuna e Drenasit për neve.

Një kohë i kemi pasur në shfrytëzim ato prona, por kalimi nga një system në tjetrin na ka dhanë mundësi me i pas në prona tona personale që kemi dëshmi certifikat e pronësisë. Faktikisht ashtu siç thonju kryetar duhet me zbatu ligjin.

Ligji e mundëson që dikush në periferi të Drenasit me bë një ndërtim me interes shtetëror, por ju e dini dallimin e vlerës në periferi të Drenasit me atë në qendër të saj. Unë jam pror i shtëpisë në atë pror dhe po kërkojë që të vlerësohet shtëpia ime që është në një ari tokë me një ari tokë.

Me kompenzu një ari që shkon prej 80 mijë euro deri në 100 mijë euro. Edhe ligji ju thotë me bë komisionin, komisioni që ka dal dhe ka bë kompenzimin ka dal dhe ka pyet rrugës së kushton një meter katror, ju kanë thënë 300 deri në 500 euro më së larti, aq kushton dhe pronën time që e kam në përdheze që e kam autoshkollë që e kam mbindërtu, që e kam bë në kohë emergjente, kam bë kërkësë për legalizim që me ligjin e 2013-ës thotë, të gjitha ndërtimet që janë bë pas vitit 2013 i nënshtronen legalizimit.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Murtez Zogu (Shfrytëzues i banesës që ju bëhet shpronësimi) – Kurr nuk na është dhënë përgjigje. Po katër përdhes, sot dalim dhe shkojmë para shtëpisë sime dhe e qesim shpaljen se shitet ky lokal deri në 2000 euro shkon metra katror.

Investitorë që investon shembull 4 shtëpi, ato 4 shtëpi e marrin një sipërfaqe prej 20 ari, jau kam lane që 40% do jetë gjelbërim, 60 % ndërtim efikas, bëhen 1200 metra katror vetëm në katin përdhes, shkojnë dy katë nëndhe shkojnë 6-7-8 katë.

Katër persona ka me jau pagu vlerën për seciliën kat e ka nga 1200 metra katror, që asnjë kat deri në 1000 euro nuk i jetë muaji. Ju thoni që nëse nuk pajtoheni shkoni në Gjykatë, juve nuk jaka lane përgjegjësinë gjyqi por ka thënë vendos kryetari. Jemi të gjithë me na bë zgjidhje. Sepse këtu Komuna e ka interesin sepse merr 12 shtëpi taksa, here 8 kat.

Komuna e ka interesin e taksave. Investitorë e ka interesin komercial kurse ne e kemi interesin që e shohim qytetin e bukur dhe ne nuk dëmtohemi.

Ne ato banesa i kemi marrë para 50 vjetë, nevojat kohore kanë bë që nuk kemi pasur qare pa u zgjeru sepse janë ardhur nevojat për me u zgjeru. Nuk është koha me jetu qysh kemi jetu më herët.

Vlerësimi i pronës sime Islamic Relief, 150 mijë euro i kanë jep veç me jau dhënë pronën. Duhet me pas edhe një çështje parasysh se ato shtëpi i kanë qenë të djegura të gjitha, më shumë na është bërë meremetimi sesa me pas ndërtu të re. 37 mijë marka më ka kushtu investimi në atë shtëpi që i kam bë për me qenë e banueshme. Për fillim qekaq kryetar mos të ju marrë më shumë kohë, faleminderit që jeni ardh.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme

Kryetari Lladrovci – Tjetri, ju kisha lutur me fol më shkurt se pse krejt çka ka folur profa nuk është që na hynë në punë neve këtu.

Afirm Hysenaj (shfrytëzues i banesës që do shpronësohet) – Përsëndetje kryetar, përsëndetje të gjithë të pranishmit, siç e tha edhe Murtezi këto banesa kanë qenë që të dëgjura të gjitha dhe krejt paslufte i kemi renovuar.

Unë kisha besu që kryetari që është përgjegjës për shpronësimin është edhe përgjegjës edhe për mos me u dëmtu ne si banorë aty. Në formën qysh është bë vlerësimi i pare për këmbim ka qenë më i pranueshëm se pse na ka bërë zgjidhje për jetesë.

Njëfar forme nga banor resident po kalojmë në banorë jorezident sikur po na largojnë prej Drenasi për arsyje që kryetari sipas ligjit nuk po ka mundësi me na këmbby me banesa tokën tonë. Ne jemi të bindur që jemi pronarë vetëm të banesave jo të pronës.

Vlerësimi i parë ka qenë më shumë se katastorfal dhe mirë që është shfuqizuar.

Derisa ligji është tek kryetari ndoshta mundet me na bë banor resident me na gjitet ndonjë zgjidhje për banim.

Edhe kryetari tha nuk kam qasje në atë vendim nga komisioni vlerësues për shpronësim. Me na bë një zgjidhje më adekuate për banim se pse ne nuk jemi me bloku e gjithë procesin. Shpresoje në mirëkuptimin e kryetarit me na ndihmu me realizu një banim të përhershëm për neve si banorë të atyre banesave.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtishme

Shkumbin Morina (shfrytëzues i banesës që do të shpronësohet) – E përfaqësojnë edhe vëllaun tim Shpëtimin, kështu vëretjen e parë e kam tek vlerësimi i parë më intereson me ditë që vlerësuar nuk kanë lypur dokumentacion prej meje edhe këtu e shoh që banesa jem është e ndërtuar në vitin 1961, e këtu thotë që është e ndërtuar në vitin 1959 dhe e kanë vlerësuar në koeficientin 0.7 dhe klasa e 4 me pas vlerësu në vitin 1961 e kishte pasur koeficientin 0.8 dhe do të ishte klasa e 3-të, unë këtu e kam edhe llogaritjen ku tregon që është ndërtuar në vitin 1961.

Personalisht nuk jam kundër ndërtimeve, personalisht jam me kundër me zgjatë shetitore, për arsyje që i kemi afër tek M200 tek Bucolli tek Korabi tek ata, kur kanë ndërtuar ata nuk kanë lane hapësirë dhe tash nuk kanë ku me i lane kerret dhe investitorëve me na hjkë prej atyhit.


Ku i kanë pasur syftë ata blerës kur e kanë ble që nuk kanë kqyr që nuk ka hapësirë. E dyta unë nuk jam kundër shpronësimit por le të ma kompenzon në çmimin real.

Një garazh Idriz Hyseni e ka shitë dikun për 5-6 mijë euro, sot qajo garazh i bën 10 mijë euro, njëjtë i ka shitë edhe Altrade.

Investitori kur të vjen e hjkë banesën tem, hynë më poshtë, katin e parë e shet 2 mijë euro metrin katror, katin e dytë e shet 1 mijë euro për meter katror, kate tjera nuk janë më interesant për të.

Faktikisht për 61 metra të mija 494 mijë euro po i hyp vlera investorit e tash me u çu me 27 mijë euro sikur herën e kalune nuk është më rregull kryetar. Nuk jam unë i interesuar unë me ja shyt investorit kohën e punimeve por nëse unë e dërgoi në gjykatë unë humbi se çfarë bëhet me neve, unë e paguaqej tatimin për atë pronë.

Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme




Behije Demaku (Banore në lagjen në fjalë) – Nuk është vetëm me gjyq se jemi lodhë, është humbje kohe, e kena fitu lirinë, ta gëzojmë krejt njësojë, kam shumë emocione, jam shumë e zhgënjer me këtë qeveri.

Unë jam mësuese por edhe shujtat nuk i gëzojmë, ku ja ka dhanë kryetar. Jeni prej një familje shumë të respektume, por duhet të i shikoni gjërat shumë më me zemër kryetar.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Kryetari Lladrovci – Edhe njëherë po ja kuitojë që ne kemi pasur dëgjime publike për këto çështje, edhe ju një pjesë keni qenë në dëgjime publike, sidomos ju prof, të mbajë mend që keni qenë, Hysenaj.

Qëllimi i im ka qenë që ju me i ndërru banesat që i keni në shfrytëzim me banesa të Komunës, dhe ju vet keni pranu atë ndërrim.

Unë edhe njëherë jau kujtojë, nuk caktojë vlera të cilat duhet me ju dhënë Komuna, e caktion një institucion i veçantë shtetëror që janë të pavarur nga ne.

Ata dalin e bëjnë vlerësimin dhe masin gjithë objektet.

Murtez, professor, edhe ju të gjithë të tjerët, nuk është faj i mëdha që ju shkoni nëpër gjyqë sepse nuk e kam asnjë mundësi ligjore me hifikë këtë problem pa i ndjekur ato procedura.

Certifikatat e pronësisë, unë interesat e juaja i përfaqësojë, por i përfaqësojë edhe gjithë qytetarëve të Komunës, jo vetëm të juajat. Prona nëse ka qenë e djegur ka qenë e Komunës jo e juaja.

Ju është dashjtë me i bë disa kërkesa komunës për me intervene në pronë të Komunës. Nuk bëhet illogari professor me ari të tokës se toka nuk është e juaja, është e komunës. Prandaj, shpronësoheni për aq sa e ka vlerën objekti jo toka. Ata tjeter i kanë edhe nga 7-8 ari që janë të Komunës dhe që e kanë qitë mbi veti. As nuk keni pasur të drejtë me i shitë këto prona se thatë që ju kanë ofuar nga 150 mijë euro.
to sepse nuk janë të juajat. Objektet e juaja i kanë vlerësuar për shkak të vjetërisë për shkak të dërmave sepse gjysma nuk jeton si ky k...

Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme

Kryetari Lladrovci – Unë kam prit që juia vlerësojnë më tepër për ata kemi dashur të bëjmë ndërrimin e tyre me banesa të tjera. Ke bë autoshkollë prof, ke bë mbindërtim, ke bë në kohën e Nexhat Demakut, në kohën time, as ti as askush nuk ka këtu me bë çka të dëshirojë.

Ke punu zyrtar asnjë veprim nuk ke pasur të drejtë me bë aty, as autoshkollë as asgjë me bë aty. Më falni ju tjerët nuk e kam për ju. As ligji nuk i legalizon mbindërtimet në pronën publike, prandaj statusi i pronave tuaja është ky që është.

Cili ligj ma lejon mua atë që po e thoni që na, unë po mbës i kënaqur që juve po ja vlerëson ulët, unë kam zhvillu procedura me ndërru shtëpi për shtëpi, banesë për banesë, unë nuk jam i kënaqur me këtë vlerësim por ligjin nuk e shkel li se nuk shkojë në burg për kërkend.

Afrim, zbatim të ligjit jam duke u mundu me bë, ligji nuk më obligon me qenë në këtë takim, veç me ju tregu që unë bashkëndjejë me juve, aq është mundësia jem, vlerësimin e banesave e ka bë tjetër kush, jo unë, por nuk e lejojë që qendra e qytetit me qenë ashtu aq e degraduar. Unë e di që është zor me u marrë me procese gjyqësore por nuk kam as unë tjetër zgjidhje.

Shkumbin, vlerësuesit the nuk kanë kërkuar dokumente, por Gjykata ka qenë me vlerësuesit e saj dhe u ardhë i ka pa banesat, çdo banesë është e regjistruar dhe kush shkon në gjyq kur gjë nuk humbë. Nëse ka gabime teknike do evidentohen në gjykate, është duke u zhvillu proces i ri i vlerësimit. Ndërtimi tjerëve, krejt kundërligjishëm i kanë bë ato ndërtime, që nuk kanë lënë asnjë hapsirë, kundërligjishëm i kanë bë, janë në proces gjyqësor ata zyrtarë që i kanë leju ato ndërtime pa asnjë kusht. Kompenzimi me vlerësim real, unë nuk kam asnjë mundësi pa më mundësu institucioni përkates që i vlereson ato.

Baca Gani shpenzimet materiale mos me na humbë, edhe për ty vlenë e njëjtë, nuk kam të drejtë unë me caktu çmime, as me caktunë pak apo më shumë, është institucion i pavarur.

Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme


Behiye Demaku ([Banore në lagjen në fjalë](#)) – Mësuese unë jam mundu me vlerësu punën që e keni bë, ju kam dhënë mirënjoyje për punën tuaj, hallet i kam marrë për zemër, por temat që i ngrite ti, që vëllau është i papunësum, unë nuk bëjë punësim, kam qindra të tillë të papunësuar, unë krijojë kushte me u bë punësim, tjetër gjë nuk bëjë unë. Dole edhe tek shujtat, prandaj nuk kam asnijë kod me i qitë paratë, për ata i kemi qitë në gjyq sepse nuk kemi pasur faj ne, vendimet që i ka marrë një minister në kurriz të komunave dhe dëmet komunave që ju kanë bë 6 milionë e diçka krejt kryetarët e komunave e kemi quar në gjykatë, duhet me pas kodin nëpërmjet të cilit duhet me i pagu shujtat.

Mos të hyjmë në temën e shujtave sepse nuk është kjo tema e sotit, është një temë krejtësisht tjetër. Ju kisha lutur që të i ndiqni procedurat sepse nuk kemi mundësi të tjera për me ju bë zgjidhje juve. Unë nuk gëzohem që ju merrni vlerësim më të vogël për banesat e juaja.

Shkumbin Morina – Kryetar a di me ma spjegu që po thu nuk keni pasur të drejtë me i ndërtu pas luftes se nuk janë të juajat, e dyta unë nuk jam shfrytëzues por jam pronar, shfrytëzues kam me qenë vetëm deri më 1993 kam muijtë me qenë shfrytëzues. Në certificate të pronësisë nuk shkruan shfrytëzues por pronar.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Kryetari Lladrovci – A je vetëm pronar i objektit, a ke marrë leje për me ndërtu kur është shkatërru, ata që se kanë pasur në pronë të vetën nuk kanë pasur të drejtë me ndërtu sepse nuk kanë marrë asnjë here leje sepse është kanë pronë vetëm e Komunës.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Murtuz Zogu (Shfrytëzues i banesës që ju bëhet shpronësimi) – Me thane pas luftës kur janë djequr prej Serbisë nuk keni pasur të drejtë me i ndërtu nuk e hanë pazi këtë punë, unë kam qenë drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Qeverinë e Përkohshme të Komunës, krejt meremetimet e gjitha komunave dhe gjitha fshatrave 6700 shtëpi i kemi pasur të djequra në shkallën e 4-të, janë shkuar përmes dorës time, nuk i kemi bërë ne investimet por i kanë bërë shoqatat humanitare.

Kulmet e këtyre shtëpiave që janë kanë të djequra këtu, jau kanë dhanë shoqatat humanitare, meremetimin e kanë bë vet.

Kërkosë e kemi kryetar, se nuk u kanë zgjidhje as me ma marrë mua në katën e pare e me më çu në katën e pestë, por kërkesa jonë është vjen investitori ndërtton, shtëpia ime është 81 metër katror bruto, atëherë për mos me pagu qera shumë ja kanë bë 60 e diçka qysh u kanë më herët atëherë.

Edhe njëherë po të them, tu kisha latur, lirohu prej komplekseve me ja ndalë fjalën dikujt që ju keni qenë mik i dikuit a diçka tjetër. Unë shtëpinë e kam ndërtu tek administratorët e përkohshëm ndërkombëtar që kanë qenë. ●



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme




Kryetari Lladrovci – Prof, më the një fjalë a e hanë pazar, unë po të them që shumë e hanë, hale më keq kur the kam qenë zyrtar në Komunë dhe ke bërë ndërtim kundërligjshëm, hale më keq. Të lutem se të ndëgjova.

Në vendin që banojnë tërë këta njerëz ke bë biznes, unë i kam ndalur dhe ka me i ndal por moral mos më shitni askush sepse një zyrtar që ka punuar vet dhe e ka shkelur ligjin vet, nuk ka nevojë me na shitë moral këtu.

Ata që kanë mbindërtu ose kanë ndërtu pronën mbi veti kanë bërë veprime në kundërshtim me ligjin. E kam pru edhe Kushnerin këtu tek ju, në Poklek, e disa vende tjera, por ata që nuk e kanë pasur pronën në emër të vetin kanë vepruar kundërligjshëm.




Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Ruzhdi Lestrani : Kjo është faza e pare, dëgjimi publik, pas kësaj vazhdon vendimi preliminar pas kësaj vjen vendimi përfundimtar, për me ardhë përfundimi duhet me u kry vendimi preliminary, gjatë vendimit preliminar dërgohet kërkesa për vlerësim të pronave, nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme e cila është në kuadër të Ministrisë së Financave e cila bën këtë vlerësim në bazë të ligjit përkatës.



Dëgjimit Publik – Shpronësimi i Pronës së Paluajtshme



Ramiz Llakoci




Kryetar i Komunës së Drenasit

Ruzhdi Lestani

Drejtør i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi në Komunën e Drenasit

Avdyl Mziu



Zëdhënës i Komunës